



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 258

Tiranë – E premte, 6 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 77, datë 19.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 1006, datë 24.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2016-107, datë 30.3.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	26505
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 27.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2015-761, datë 5.2.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. 2592, datë 30.11.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	26509
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 79, datë 27.12.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj.....	26512



VENDIM
Nr.77, datë 19.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 8.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 66 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Albadita” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Invo-1100” sh.p.k., Ministria e Energjisë dhe Industrisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 1006, datë 24.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2016-107, datë 30.03.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, shoqërisë “ALBADITA” sh.p.k., që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “INVO-1100” sh.p.k., që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ushtron aktivitet në fushën minerare të nxjerrjes së kromit sipas lejes së shfrytëzimit të dhënë nga Ministria e Energjisë

dhe Industrisë (Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në kohën kur është dhënë leja). Ajo ka marrë me qira si aset linjën e shkarkimit të mineralit nga shoqëria “Albkrom” sh.a.

2. Subjekti i interesuar, shoqëria “INVO-1100” sh.p.k., ushtron gjithashtu aktivitet në fushën minerare mbi bazën e lejes së shfrytëzimit të dhënë po nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3. Të dyja këto shoqëri ushtrojnë aktivitet mbi një pjesë të dubluar të sipërfaqeve të licencuara. Deri në mesin e vitit 2009 ato kanë punuar normalisht duke shfrytëzuar me radhë pjesën e dubluar të sipërfaqes së shfrytëzimit. Më pas, midis dy shoqërive kanë lindur mosmarrëveshje për sa i përket shfrytëzimit nga kërkuesja të skemës së transportit të marrë si aset nga “Albkrom” sh.a. (në likuidim).

4. Kërkuesja ka pretenduar se shoqëria “INVO-1100” sh.p.k. ka penguar shfrytëzimin e skemës së transportit dhe për këtë arsye ajo i është drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, konkretisht Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit dhe Projekteve, për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Në shkresën nr.1244, datë 19.05.2010, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka bërë me dije palët se pas verifikimeve rezultoi se është shoqëria “INVO-1100” sh.p.k. që ka punuar duke penguar kërkuesen në skemën transportit, e cila është pjesë përbërëse e lejes së kërkueses. Ministria ka rekomanduar në këtë shkresë ndërprerjen e shfrytëzimit në zonën e dubluar nga subjekti “INVO-1100” sh.p.k. dhe kryerjen e aktivitetit të të dyja subjekteve sipas një aktmarrëveshjeje, duke respektuar rregulloren e sigurimit teknik në miniera. Kjo marrëveshje nuk është arritur, ndaj kërkuesja ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Dibër.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.456, datë 11.7.2011, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e shoqërisë “INVO-1100” sh.p.k. të shpërblejë kërkuesen për dëmin e shkaktuar në shumën 5.406.069 lekë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1006, datë 24.04.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.456, datë 11.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rrëzimin e kërkesëpadisë, pranimin e kundërpadisë,



detyrimin e të paditurit kundërpaditës të mos kryejë veprime apo mosveprime që pengojnë ose ndërpresin shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga shoqëria “IVNO-1100” sh.p.k dhe detyrimin e të paditurit kundërpaditës t’i paguajë shoqërisë “IVNO-1100” sh.p.k. shpërblimin prej 7.100.000 lekësh për dëmin e shkaktuar.

7. Ministria e Energjisë dhe Industrisë si dhe kërkuësja kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2016-107, datë 30.3.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.1006, datë 24.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

8. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se:

8.1 Është cenuar parimi i disponibilitetit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit ka vendosur, ndër të tjera, edhe detyrimin e të paditurit kundërpaditës të mos kryejë veprime apo mosveprime që pengojnë ose ndërpresin punimet apo shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga i padituri kundërpaditë, pavarësisht se kjo nuk është kërkuar në objektin e kundërpadisë. Pala e paditur ka kërkuar në kundërpadi shpërblimin e dëmit nga paditësi në masën 7.100.000 lekë, pasi sipas saj paditësi është shkaktar i ndërprerjes së punës në galerinë nr.3 si dhe prishjes së sipërfaqes së tokës sipas hartës topografike.

8.2 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit ka kopjuar tërësisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dispozitivi i këtij vendimi është kontradiktor. Ajo nuk ka arsyetuar se në cilin aspekt ka gabuar gjykata e shkallës së parë, në cilat prova e ka mbështetur ndryshimin e vendimit, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit. Këto shkelje të procesit të rregullt ligjor, të ngritura në rekurs, nuk janë konstatuar dhe as janë korrigjuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, në këtë vendim mungojnë përgjigjet për disa nga pretendimet kryesore të ngritura në rekurs.

8.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, për arsye se si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit, kanë

arritur në një konkluzion të kundërt me këtë akt ekspertimi të administruar në shkallën e parë dhe nuk kanë kryer një ekspertim të ri. Ky akt ekspertimi, sipas kërkuësjes, ka qenë prova vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Këto dy gjykata nuk kanë arsyetuar se përse e kanë anashkaluar këtë akt ekspertimi.

9. **Subjekti i interesuar, shoqëria “INVO-1100” sh.p.k.**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuësja nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

9.1 Njëri prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka lidhje të ngushta me përfaqësuesin e kërkuësjes. Në këto kushte ai duhet të përjashtohet nga gjykimi kësaj çështjeje për njëanshmëri.

9.2 Fakti që gjykatat kanë vlerësuar provat dhe kanë marrë vendim në favor të paditësit/kundërpaditës nuk i bën këto gjykata të njëanshme. Në kërkesën e saj kërkuësja ngre pretendime për vlerësimin e provave, gjë e cila është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

9.3 Gjykatat nuk kanë cenuar parimin e disponibilitetit, siç pretendon kërkuësja, pasi ato kanë vendosur vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve.

9.4 Vendimet e gjykatave janë të arsyetuara dhe të bazuara në dispozitat përkatëse ligjore dhe pretendimi i kërkuësjes për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar.

10. **Subjekti i interesuar, Ministria e Energjisë dhe Industrisë**, nuk ka sjellë pretendime në lidhje me çështjen objekt kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësjes

11. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimitimit të kërkuësjes për pretendimet e ngritura në kërkesë.

12. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të



parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej saj në kërkesë *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të disponibilitetit dhe arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit

13. Sipas kërkeses është cenuar parimi i disponibilitetit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit ka vendosur, ndër të tjera, edhe detyrimin e të paditurit kundërpaditës të mos kryejë veprime ose mosveprime që pengojnë apo ndërpresin punimet ose shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga i padituri kundërpaditës, pavarësisht se kjo nuk është kërkuar në objektin e kundërpadisë. Gjithashtu, kërkesja pretendon se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit ka kopjuar tërësisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dispozitivi i këtij vendimi është kontradiktor. Ajo nuk ka arsyetuar se në cilin aspekt ka gabuar gjykata e shkallës së parë, në cilat prova e ka mbështetur ndryshimin e vendimit, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit.

14. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës individit mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkëljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton që kërkesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkëlura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr.3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit

gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese.

15. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr.28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi kushtetues i kërkesave individuale udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr.19, datë 2.4.2012; nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr.31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata, duke shqyrtuar materialet e dosjes gjyqësore, konstaton se kërkesja pretendimet e saj për cenimin e parimit të disponibilitetit dhe të arsytimit të vendimit gjyqësor, nuk i ka ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos shteruar mjetet për t'iu drejtuar kësaj gjykate.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim

18. Kërkesja ka pretenduar se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, për arsye se si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit, kanë arritur në një konkluzion të kundërt me këtë akt ekspertimi të administruar në shkallën e parë dhe nuk kanë



kryer një ekspertim të ri. Ky akt ekspertimi, sipas kërkukses, ka qenë prova vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vetëm fakti që është i administruar në dosje nuk mjafton për të vlerësuar se është marrë si provë nga Gjykata e Apelit. Si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsytuar se përse e kanë anashkalluar këtë akt ekspertimi duke e vendosur kërkuksen në disavantazh me palën tjetër.

19. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr.34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren, dhe mënyra e vlerësimit, si dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr.2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet dhe komentet e palës tjetër, e bën procesin gjyqësor të cenueshëm. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtarë, që nënkupton në parim mundësinë

që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr.17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe i mundësisë për të dhënë argumentet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr.34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuësja ka qenë e pranishme gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit dhe ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e veta në seancë gjyqësore. Po kështu, edhe në Gjykatën e Lartë ajo ka paraqitur rekurs, ku ka parashtruar të gjitha pretendimet e saj. Pra, kërkukses nuk i është mohuar e drejta për të paraqitur përpara gjykatave çështjen e saj. Argumentet e kërkukses për të justifikuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim lidhen me vlerësimin e gjykatës për sa i përket provës që ajo e konsideron si vendimtare në proces. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkukses është i pabazuar.

23. Nisur nga sa më lart, Gjykata në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuësi është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Vitore Tusha

VENDIM

Nr.78, datë 27.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“	
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“	
Gani Dizdari	anëtar i	“	“	
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“	
Fatos Lulo	anëtar i	“	“	
Vitore Tusha	anëtare e	“	“	

me sekretare Edmira Babaj, në datën - 17.11.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 58 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Nargis Lungu Shkreli

SUBJEKTE TË INTERESUARA: LIVIA SHKRELI, MARLIND SHKRELI, INGRID SHKRELI DANO

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2015-761, datë 05.02.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.2592, datë 30.11.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,

Livia Shkreli, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi se subjektet e tjera të interesuara, Marlind dhe Ingrid Shkreli, nuk kanë paraqitur prapësime, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me testamentin nr.6, datë 13.02.1996, testatorja Lejla Shkreli ka përcaktuar si trashëgimtare vajzën e saj Nargis Lungu Shkreli (kërkuesja). Testatorja ka pasur tre fëmijë, përkatësisht kërkuesen dhe djemtë, Tarik dhe Vildan Shkreli. Subjektet e interesuara, Livia Shkreli (stërmbesa e testatores) dhe Ingrid Shkreli (mbesa e testatores), kanë ngritur padi në gjykatë për pavlefshmërinë e testamentit, duke kërkuar njohjen e tyre si trashëgimtare ligjore të Lejla Shkrelit në 1/3-ën pjesë të pasurisë të përcaktuar në testamentin e lënë prej saj.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.10018, datë 23.12.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve të interesuara.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2592, datë 30.11.2011, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm, konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të testamentit dhe detyrimin e kërkueses të njohë Livia Shkrelin si trashëgimtare të trashëgimlënësës Lejla Shkreli në 1/3-ën pjesë të pasurisë së disponuar me testament, si dhe rrëzimin e padisë për Ingrid Shkrelin.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2015-761, datë 5.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.2592, datë 30.11.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

5. **Kërkuesja Nargis Lungu Shkreli** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se:

5.1 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi ajo i ka fituar të drejtat e pronësisë në bazë të testamentit. Padija për kundërshtimin e testamentit është ngritur pas 8 vjetësh, pasi ishte çelur trashëgimia, ndërkohë që sipas nenit 411 të Kodit Civil (KC) kjo lloj padie ngrihet brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar të drejtën



e pronës, duke e zgjidhur çështjen në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi (nenet 94, 112, 361, 379 e 411 të KC-së).

5.2 Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në çështje të ngjashme, duke shkelur parimin e paanshmërisë dhe objektivitetin në gjykim. Gjyqtarët, pjesë e trupit gjykues, kanë mbajtur qëndrime të kundërta me zgjidhjen që ata kanë dhënë në vendime të tjera gjyqësore për të njëjtin shkak ligjor.

5.3 Vendimet e gjykatave, përveçse vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 379 të KC-së, nuk kanë marrë parasysh faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një testament me titull të posaçëm dhe jo me titull universal, ndaj për rrjedhojë testatorja nuk i ka përjashtuar nga trashëgimia ligjore dy djemtë e saj, Vildan e Tarik Shkreli. Ato vijnë gjithashtu në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 1/2014 të Gjykatës së Lartë.

6. **Subjekti i interesuar Livia Shkreli** ka prapësuar si vijon:

6.1 Pretendimet e kërkueses janë të njëjta me ato që ajo ka paraqitur në rekurs dhe kanë të bëjnë me problemet e zbatimit të normave konkrete të ligjit material. Këto lloj pretendimesh nuk përbëjnë juridiksion kushtetues bazuar në jurisprudencën e Gjykatës. Kërkuësja ka kërkuar shqyrtimin në themel të natyrës së testamentit, pretendim i cili del haptazi jashtë natyrës së gjykimit kushtetues.

6.2 Ligji është respektuar plotësisht nga të dyja gjykatat më të larta. Kërkuësja e lexon ligjin gabim; qëndrimi i saj se testatori mund ta përjashtojë nga testamenti pasardhësin e mitur të thirrur me zëvendësim, bie ndesh me praktikën gjyqësore dhe vendimin unifikues nr.1/2014 të Gjykatës së Lartë. Padia e kërimit të trashëgimisë, ndryshe nga sa pretendon kërkuësja, nuk parashkruhet, bazuar kjo në vendimin unifikues nr.5/2011 të Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkueses

7. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e saj, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione*

temporis, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* vërehet se kërkuësja ka ngritur pretendime për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Këto pretendime të paraqitura nga kërkuësja janë shqyrtuar në vijim nga Gjykata në kuadrin e procesit të rregullt ligjor.

B. *Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike*

9. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke parashtruar se të drejtat e pronësisë ajo i ka fituar në bazë të testamentit. Padia për kundërshtimin e testamentit është ngritur 8 vjet pasi ishte çelur trashëgimia, ndërkohë që sipas nenit 411 të KC-së kjo lloj padie ngrihet brenda tre vjetëve nga çelja e trashëgimisë. Gjithashtu, ajo ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në çështje të ngjashme të cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe se vendimet e gjykatave vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e testamentit, me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe me vendimin unifikues nr.1/2014 të Gjykatës së Lartë.

10. Gjykata ka theksuar vazhdimisht në jurisprudencën e saj rëndësinë e parimit të sigurisë juridike si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimet nr.25, datë 28.4.2014; nr.20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr.15, datë 19.4.2013; nr.37, datë 13.6.2012; nr.23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga rrethanat e çështjes konkrete Gjykata vëren se testamenti është përpiluar në datën 13.02.1996 nga testatorja Lejla Shkreli, e cila ka ndërruar jetë në datën 12.10.2002. Në këtë testament përcaktohet si trashëgimtare e vetme e pasurive të përcaktuara, konkretisht e pronave të kthyer me vendime të KKKP-ve, që testatorja i



ka trashëguar nga babai i saj, vajza e saj Nargis Lungu Shkreli. Me vendimin nr.6479, datë 9.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore, ku janë përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë fëmijët e testatores, pra vajza Nargis Lungu Shkreli, si dhe djemtë, Vildan dhe Tarik Shkreli. Testatorja i ka përjashtuar të dy djemtë nga testamenti në mënyrë të heshtur. Subjekti i interesuar, Livia Shkreli, si mbesa e Vildan Shkrelit, ka kërkuar në gjykatë pavlefshmërinë absolute të testamentit dhe njohjen si trashëgimtare për shkak të rezervës ligjore, pasi në kohën e çeljes së trashëgimisë ka qenë në barkun e nënës dhe për këtë arsye, sipas nenit 379 të KC-së, nuk mund të përjashtohet nga trashëgimi. Duke qenë se gjyshi i saj Vildan Shkreli dhe babai i saj Marlind Shkreli kanë qenë të përjashtuar nga trashëgimi, asaj (Livas), si trashëgimtare me zëvendësim, nuk mund t'i cenohej rezerva ligjore e parashikuar në nenin 379 të KC-së.

12. Sipas nenit 379 të KC-së “trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paafte për punë, në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar”. Kjo rezervë ligjore referon në nenin 361/2 të KC-së që parashikon: “Kur një nga fëmijët [...] është përjashtuar nga trashëgimi, në vend të tij hyjnë me zëvendësim fëmijët e tij dhe kur për shkaqet e sipërme nuk mund të jenë trashëgimtarë, vijnë në trashëgim të paslindurit e tyre pa kufizim. Në këtë rast, pjesa e prindit që nuk trashëgon ndahet ndërmjet të paslindurve në pjesë të barabarta”.

13. Bazuar në këto dispozita ligjore materiale gjykata e shkallës së parë ka konkluduar, ndër të tjera, se pretendimi i paditëses Livia Shkreli për pavlefshmërinë e testamentit, për arsye se ka cenuar rezervën ligjore (nenin 379 të KC-së), është i pabazuar, dhe për rrjedhojë ka rrëzuar kërkesëpadinë. Më konkretisht, ajo ka arsyetuar: “Megjithëse Livia Shkreli ka qenë zënë para vdekjes së testatores, vetëm ky moment nuk e

bën atë trashëgimtare ligjore të saj. Në testament është përjashtuar në mënyrë të heshtur djali Vildan Shkreli (babai i Ingridit dhe gjyshi i Livias), por në momentin e çeljes së trashëgimisë fëmijët e Vildanit (Marlind dhe Ingrid) kanë qenë madhorë mbi 18 vjeç. Për rrjedhojë, Livia Shkreli nuk thirret në trashëgimin ligjor edhe sikur të kishte lindur para vdekjes së testatores, pasi në trashëgiminë e saj ligjore thirret babai i saj Marlind me cilësinë e fëmijës së përjashtuar nga trashëgimi. Pra, Livia Shkreli nuk gëzon mbrojtjen e rezervës ligjore, pasi trashëgimtar ligjor i testatores është babai Marlind së bashku me motrën Ingrid, të cilët zënë vendin e babait të tyre të përjashtuar Vildan” (*shih fq.7-8 të vendimit nr. 10018, datë 23.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

14. Gjykata e Apelit e ka vlerësuar të gabuar interpretimin e ligjit që ka bërë gjykata e shkallës së parë. Ajo është shprehur se trashëgimlënësja ka vepruar në kundërshtim me nenin 379 të KC-së kur ka përjashtuar të miturën Livia Shkreli që trashëgon me zëvendësim, sipas nenit 361/2 të KC-së, në rrethanat kur, ashtu siç është përjashtuar nga trashëgimi indirekt (nëpërmjet heshtjes) fëmija trashëgimtar Vildan Shkreli, është përjashtuar nga trashëgimi edhe fëmija i Vildanit, Marlind Shkreli, duke bërë që me zëvendësim për këtë trashëgimtar (Vildan Shkrelin) të hyjë fëmija i fëmijës së tij, Livia Shkreli (*shih fq. 11-12 të vendimit nr.2592, datë 30.11.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

15. Gjykata e Lartë ka mbajtur të njëjtin qëndrim si Gjykata e Apelit, duke e konsideruar absolutisht të pavlefshëm testamentin. Ajo në të njëjtën linjë arsyetimi me Gjykatën e Apelit ka vlerësuar: “Nëse trashëgimlënësja ka vepruar në përputhje me të drejtën e saj të ligjshme kur ka përjashtuar nga trashëgimia trashëgimtarin ligjor të saj, fëmijën Vildan Shkreli, ajo ka disponuar në kundërshtim me nenin 379 të KC-së kur ka përjashtuar nga trashëgimia ligjore edhe të miturën Livia Shkreli që trashëgon me zëvendësim referuar nenit 361/2 të KC-së, në rrethanat kur ashtu siç është përjashtuar nga trashëgimi indirekt (nëpërmjet heshtjes) fëmija trashëgimtar Vildan Shkreli, është përjashtuar nga trashëgimi edhe fëmija i tij, Marlind Shkreli, duke bërë kështu që me zëvendësim për këtë trashëgimtar (Vildan Shkrelin) të hyjë fëmija i



fëmijës së tij Livia Shkreli [...]. Nisur nga një përfundim i tillë, referuar nenit 407 të Kodit Civil, testamenti objekt gjykimi është absolutisht i pavlefshëm, për sa i përket disponimit me këtë testament për përjashtimin nga trashëgimia ligjore të trashëgimtares së mitur Livia Shkreli” (shih fq. 4-5 të vendimit nr.00-2015-761, datë 5.2.2015 të Gjykatës së Lartë).

16. Kërkesja ka pretenduar se gjykatat e kanë zgjidhur çështjen në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendimin unifikues nr.1/2014 të Gjykatës së Lartë. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata rithekson qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (shih vendimet nr.40, datë 25.6.2015; nr.4, datë 5.2.2014; nr.34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në çështje të ngjashme. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata nënvizon se kontrolli i zbatimit në mënyrë uniforme të ligjit material hyn në juridiksionin e Gjykatës së Lartë, e cila vendos të bëjë unifikim të praktikës nëse janë rastet për ta bërë këtë. Gjithashtu, Gjykata vëren se pasi janë dhënë vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi, i njëjti testament i është nënshtruar përsëri shqyrtimit gjyqësor për pavlefshmëri dhe njohje të pjesës trashëgimore në gjykatat e zakonshme. Gjatë këtij gjykimi Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.553, datë 27.02.2015 të formës së prerë, ka arsyetuar në harmoni me qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.1, datë 19.2.2014 dhe në të njëjtën linjë që kanë ndjekur gjykatat në vendimet objekt shqyrtimi. Për pasojë, argumentet e parashtruara

si më lart nga kërkesja nuk janë të mjaftueshme që të bindin Gjykatën për cenimin e parimit të sigurisë juridike në kuadrin e procesit të rregullt ligjor.

17. Rrjedhimisht, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkeses për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr.79, datë 27.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.12.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 82 Akti që i përket:

KËRKUESE: Silvana Lamaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Përmbarrimore “Debit Collection”, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale



OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesues, Silvana Lamaj, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesja ka qenë e punësuar pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (ish-Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në vijim MPMS), në pozicionin e specialistes së Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Me aktin administrativ nr.749, datë 7.4.2010 të ministrit, kërkesja është liruar nga detyra për shkak të ndryshimit të kërkesave të punës.

3. Pas ankimit të bërë nga kërkesja në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), ky i fundit, me vendimin nr.117, datë 23.11.2010, ka vendosur: *“Pranimin e ankesës së ankesues S.L. Shfuqizimin e aktit administrativ nr.749, datë 7.4.2010 si absolutisht të pavlefshëm. Kthimin e ankesues në pozicionin e specialistes së Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Drejtorinë e Integritimit European. Pagimin e pagës nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare deri në kthimin në pozicionin e specialistes së Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Drejtorinë e Integritimit European[...].”*

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.52, datë 30.5.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.117, datë 23.11.2010 të KSHC-së.

5. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.58, datë 30.6.2011, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr.52, datë 30.5.2011.

6. Pas rekursit të paraqitur nga MPMS-ja, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2013-1716, datë 4.7.2013, vendosi mospranimin e rekursit, për arsye se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

II

7. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

7.1. Nga ana e zyrës përbarimore dhe MPMS-së nuk janë përmbushur detyrimet për të vënë në zbatim vendimin gjyqësor të formës së prerë.

7.2. Edhe pse nga ana e MPMS-së është ekzekutuar një pjesë e vendimit, zyra përbarimore e ka cenuar duke mbajtur një pjesë për veten e saj.

8. Subjektet e interesuara, zyra përbarimore “Debit Collection” dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkeses

9. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr.52, datë 20.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata vlerëson se kërkesja ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret ajo u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së saj. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkesja i është drejtuar shërbimit përbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm, i cili ka vijuar procedurat për vënien në ekzekutim të këtij vendimi.

11. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesja legjitimohet për t’iu



drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ajo ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

12. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr.21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

14. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 21, datë 7.4.2014; nr.14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të

procedurës gjyqësore deri kur jepet vendimi dhe ekzekutohet. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtut proces (*shih vendimin nr.14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

17. Duke e vlerësuar çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, në rastin konkret rezultoi se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë 30.06.2011 deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë më shumë se 5-vjeçare. Një periudhë e tillë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor konsiderohet si e paarsyeshme dhe e gjatë.

i) Kompleksiteti i çështjes

18. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr.15, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për kthimin e kërkueses në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e detyrimeve monetare përkatëse. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe i kërkueses është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Interesi dhe sjellja e kërkueses

20. Në rastin konkret interesi i kërkueses është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e kërkueses për t'u kthyer në punë dhe për t'u paguar. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultoi se ajo ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ajo ka shfaqur interes të



vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

21. Me aktin nr.794, datë 7.4.2010 të ministrit të MPMS-së është njoftuar për kalimin në listë pritjeje për shkak të ristrukturimit të vendit të punës. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuesja i është drejtuar KSHC-së, duke kërkuar shfuqizimin e aktit të ministrit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës. KSHC-ja, me vendimin nr.117, datë 23.11.2010, ka pranuar kërkesën e kërkueses, duke shfuqizuar aktin nr.794, datë 7.4.2010 të ministrit të MPMS, si dhe ka urdhëruar kthimin e ankueses në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare deri në kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.52, datë 30.05.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.117, datë 23.11.2010 të KSHC-së. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata e Apelit, me vendimin nr.58, datë 30.6.2011, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr.52, datë 30.5.2011.

iii) Sjellja e autoriteteve

22. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr.24, datë 22.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr.8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbauesit

gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se shoqëria përmbauese "Debit Collection" i është drejtuar me shkresën nr.15 prot. të datës 28.2.2012 MPMS-së për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të vendimeve dhe më tej me shkresën nr.15/3 prot. të datës 5.03.2012 për ekzekutimin e detyrueshëm. Gjithashtu, me shkresën nr.15/3 prot. të datës 5.3.2012 shoqëria përmbauese i drejtohet MPMS-së dhe Degës së Thesarit Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative në depozitat e MPMS-së. Me shkresën nr.500/1 prot. datë 8.3.2012, MPMS-ja i kthen përgjigje shoqërisë përmbauese se për këtë çështje ministria ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë, me shkresën nr.1503/1 prot. datë 28.5.2012, vë në dijeni MPMS-në se në rast se nuk do të procedojë sipas afateve të vendosura nga legjislacioni në fuqi, do vendosë sekuestron konservative. Me shkresën nr.1503/2 prot. datë 12.6.2012, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë ka vendosur sekuestron konservative, duke bllokuar fondet buxhetore të MPMS-së. Më pas, me shkresën nr.2219 prot. datë 18.6.2012, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Dega Tiranë vë në dijeni shoqërinë përmbauese se nga ana e MPMS-së do të vijohet me likuidimin pjesor (qershor-dhjetor) për vitin 2012, në vlerën 1000 (një mijë) lekë në muaj. Më pas, shoqëria përmbauese me shkresën nr.15/8 prot. datë 26.9.2012, ka gjobitur në shumën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë sekretarin e përgjithshëm (zotin M.M.) të MPMS-së, si person i ngarkuar nga ligji për pengim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor. MPMS-ja, me shkresën nr.500/5 prot. datë 6.11.2012, kthen përgjigje se pagesa ndaj kërkueses do të kryhet në mënyrë të pjesshme në llogarinë e saj, pasi shoqëria përmbauese nuk kishte depozituar numrin e llogarisë. Gjithashtu, MPMS-ja vë në dijeni shoqërinë përmbauese se ka bërë kërkesë në Ministrinë e Financave për një rialokim fondesh në buxhetin e saj dhe se me ardhjen e përgjigjes nga Ministria e Financave, çështjen e kërkueses do ta shikojë me prioritet. Me shkresën nr.95 prot, datë 24.04.2014, shoqëria përmbauese kërkon nga MPMS-ja kryerjen e likuidimit të plotë të shumës në favor të kërkueses në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. MPMS-ja, me shkresën nr.222/118 prot. datë 15.5.2014, i kthen përgjigje



shoqërisë përbarimore se i duhej vënë në dispozicion dosja e plotë e kërkujes dhe dokumentacioni original, si dhe urdhrat e ekzekutimit. Me shkresën nr.95/2 prot. datë 21.5.2014, shoqëria përbarimore vë në dispozicion të MPMS-së dokumentacionin e kërkuar. Pas kësaj, shoqëria përbarimore, me shkresën nr.1148 prot. datë 4.7.2014, i kërkon Degës së Thesarit Tiranë vendosjen e masës së sekuestros në llogarinë e palës debitore. Dega e Thesarit Tiranë, me shkresën nr. 4151 prot. datë 28.5.2014, vë në dijeni MPMS-në se me paraqitjen e grafikut dhe shlyerjen e detyrimeve të paraqitur nga ministria, në zbatim edhe të vendimit nr.20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund ta heq sekuestron konservative. Me shkresën nr.4434/1 prot. datë 9.7.2015, Dega e Thesarit Tiranë i kërkon MPMS-së të komunikojë zyrtarisht me zyrën e përbarimit dhe të vendosë në dispozicion vendimet gjyqësore me të gjitha të dhënat, grafikun e shlyerjes dhe gjendjen e fondit buxhetor që justifikon mosveprimin dhe parashikimin për shlyerjen e detyrimit për vitit 2015. Në rast të mos procedimit nga MPMS-ja brenda afatit, Dega e Thesarit Tiranë do të vendosë sekuestron konservative. Dega e Thesarit Tiranë, me shkresën nr.4434/2 prot. datë 16.7.2015, ka bllokuar fondet buxhetore të MPMS-së për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të kërkujes në vlerën 793.091 lekë. Këto veprime nuk krijojnë bindjen te Gjykata se është treguar vullnet për ekzekutimin e vendimit.

25. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar gjithashtu se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i

tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr.14, datë 30.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se ky i fundit nuk ka marrë masat e duhura për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin e kërkujes në punë, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv. E njëjta logjikë vlen edhe për pjesën tjetër të vendimit të formës së prerë në lidhje me detyrimet monetare.

27. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës së kërkujes për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.52, datë 30.5.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja(kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë